
OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQËNDRUARA

Data: 17/09/2026

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Studim – Projektim për “Rikonstruksion i Pjesshëm i ambjenteve të Qendrës Publike të Formimit Profesional Durrës”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP):

Sherbim per projektim ndertesash 71221000-3

KOHEZGJATJA E KONTRATËS: 70 (shtatëdhjet) ditë kalendarike

VLERA E FONDIT LIMIT: 5,241,395.54 (pesëmilion e dyqind e dyzet e një mijë e treqind e nëntëdhjetë e pesë pikë pesëdhjetë e katër) **lekë pa TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Autoriteti/enti Kontraktor **Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a.** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar. Specifikimet teknike dhe perlllogaritja e fondit limit janë hartuar dhe percjelle ne OBP, nga Autoriteti Kontraktor Perfitues (Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive)

Autoriteti Kontraktor ka hartuar kriteret e veçanta të kualifikimit duke u bazuar në analizën teknike të objektit të kontratës, vlerën e fondit limit, afatin e realizimit, kompleksitetin e shërbimit dhe rezultatet që synohen të arrihen.

Për këtë arsye, kriteret e vendosura janë të lidhura drejtpërdrejt me objektin e kontratës dhe janë proporcionale me natyrën dhe kompleksitetin e saj.

Kriteret janë hartuar ne mbështetje te: Ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar; VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", e ndryshuar; parimeve të proporcionalitetit, mosdiskriminimit, transparencës dhe konkurrencës, të parashikuara në legjislacionin e prokurimit publik.

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, **sipas shtojcës 10;**

b. Sigurimin e Ofertës, **sipas Shtojcës 3;**

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë: Sipas kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, të përcaktuara në pikën 1, Shtojca 9 të DST.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke vlerësuar që plotësimi i kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, të vendosura në pikën 1 të shtojcës 9 të DST provon mjaftueshëm përshtatshmërinë profesionale të ofertuesve.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të certifikuara të bilanceve të viteve: (2023, 2024, 2025) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese.

Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar); si dhe Kreu V, Seksioni III, Nenit 43, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik (e ndryshuar)”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit Nr.10091 date 05.03.2009 “Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar” (i ndryshuar). Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Kriteri ekonomik dhe financiar i shërben autoritetit kontraktor për të krijuar sigurinë se operatorët ekonomik kanë kapacitet financiar për zbatimin e kontratës.

2.2.2 Kopje të deklaratimit të xhiros vjetore gjatë 3 (tri) viteve të fundit financiare (2023, 2024, 2025) lëshuar nga Autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 39% e fondit limit të kontratës që prokurohet. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kontrates që prokurohet, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Kriteri i pikës 2.2.2 është vendosur referuar nenit 43, pika 2/c të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku është përcaktuar qartë vlera e kërkuar për xhiron minimale vjetore, dhe pikës 3 të nenit 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. Vlera e kërkuar është brenda kufijve të vendosur në dispozitat më sipër, dhe është vendosur me qëllim që AK të sigurohet për potencialin ekonomiko-financiar të OE ofertues, që lidhet drejtëpërdrejtë me qëndrueshmërinë dhe vijimësinë e veprimtarisë së operatorëve ekonomikë në treg, si një element i rëndësishëm në realizimin e objektit të prokurimit dhe përmbushjes së detyrimeve kontraktore.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenit 43, pika 1, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. AK në vendosjen e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 61 të Ligjit nr.29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat" si dhe kërkesat e Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, me një vlerë jo më të vogël se 19% e vlerës së përlogaritur të objektit që prokurohet.

- a) Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të realizuara.
- b) Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, nenit 55 pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 19 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në dispozitat e sipërcituara dhe duke shërbyer kështu si një garanci për AK, që ofertuesit zotërojnë kapacitete dhe eksperiencë për të zbatuar kontratën, me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie dhe në përmbushje të specifikimeve teknike.

Paraqitja e përvojës së ngjashme të realizuara si me sektorin publik ashtu edhe me sektorin privat garanton respektimin e parimit të trajtimit të barabartë dhe zgjeron mundësinë e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të disponojë licencë projektimi sipas rregullores së miratuar me VKM nr. 943, datë 28/12/2016 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale për individë dhe persona juridikë në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrje e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”.

Licenca e projektimit duhet të ketë kategoritë si më poshtë:

2.PROJEKTUES ARKITEKT

b-2. qendra tregtare; objekte social kulturore; objekte kulti; objekte arsimore

c- Projektim interiere.

3. PROJEKTUES KONSTRUKTOR

d- Vlerësimi i kapacitetit mbajtës dhe përforsimi i strukturave mbajtëse prej beton-arme, murature dhe metalike.

4. PROJEKTUES INSTALATOR

a- Projektim të instalimeve hidro-termosanitare;

b- Projektim të instalimeve termoteknike- kondicionimi, si dhe të impianteve të prodhimit të energjië termike nga burime të rinovueshme;

c- Projektim të linjave të rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale;

f- Projektim të sistemeve kundra zjarrit.;

h- Projektimi i impianteve ngritëse të transportuese (ashensore, shkallë levizëse, etj.);

j- Projektim të rrjeteve të telefonisë, citofonisë, fonisë, internetit, TV, akses kontroll, CCTV, sistemet e alarmit, sistemet e dedektimit të zjarrit, etj, për objektet civile dhe industriale;

5. PROJEKTUES VEPRA HIDRAULIKE

b- Furnizim me ujë - kolektorë shkarkimi.

8. PROJEKTUES GJEODET

a- Rivelime inxhinierike.

(Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë institucionit përkatës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës).

*Sqarim: Për licencat e lëshuara pas hyrjes në fuqi të Vendimit nr.943, datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave ‘Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes së kollaudit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë **Licenca profesionale të shoqërisë (e vlefshme) për projektim (lëshuar nga MZHUT ose institucione të tjera të autorizuar sipas legjislacionit në fuqi për dhënien e licencave profesionale në fushën e studimit të projektimit në ndërtim), e vlefshme, ku të përfshihen kategoritë e mësipërme me ndryshimet përkatëse në emërtesë.***

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4/a të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, si dhe vendimin nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes së koaludit të

punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr. 943 datë 28.12.2016” - lidhja 4 “kushte dhe kriteret specifike që kryesisht duhen plotësuar për të fituar kategoritë në fushat e studimit dhe projektimit.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente.

KATEGORIA E KËRKUAR	PIKAT E KATEGORISE	PERSHKRIMI PER KATEGORITE
Kat.2.PROJEKTUES ARKITEKT	b-2 Qendra tregtare; objekte social kulturore; objekte kulti; objekte arsimore c- Projektim interiere.	<i>Bazuar në Termat e Referencës, projektuesi arkitekt është i domosdoshëm për analizën e gjendjes ekzistuese të godinës, hartimin e projekt-ideve paraprake dhe përfundimtare, si dhe për zhvillimin e projektit arkitektonik të zbatimit. Ai do të realizojë organizimin funksional të hapësirave mësimore dhe ndarjeve të reja sipas kërkesave të programit funksional (kabinete, korridore, ambiente shërbimi), konceptimin e aksesit dhe qarkullimit vertikal (përfshirë ashensorin dhe dalje emergjente), si dhe përshtatjen e ambienteve për personat me aftësi të kufizuara. Gjithashtu, projektuesi arkitekt do të hartojë zgjidhjet për fasadat, trajtimin arkitektonik të ndërhyrjeve rikonstruktive, integrimin e elementeve të eficiencës energjetike dhe projektimin e sistemeve të jashtme, duke garantuar përputhjen me standardet bashkëkohore të projektimit për objekte arsimore dhe kërkesat e përcaktuara në dokumentacionin teknik.etj</i>
Kat.3.PROJEKTUES KONSTRUKTOR	d- Vlerësimi i kapacitetit mbajtës dhe përforcimi i strukturave mbajtëse prej beton-arme, murature dhe metalike.	<i>Bazuar në Termat e Referencës, projektuesi konstruktor është i domosdoshëm për vlerësimin e gjendjes ekzistuese të strukturës së godinës, analizën e kapacitetit mbajtës të elementeve konstruktivë ekzistues dhe përcaktimin e nevojës për ndërhyrje përforcuese. Ai do të kryejë analizën strukturore duke marrë në konsideratë ngarkesat statike dhe dinamike, përfshirë ato sizmike, si dhe do të hartojë zgjidhjet teknike për përforcimin ose përshtatjen e strukturave prej betonarme, murature apo elementeve të tjera mbajtëse. Gjithashtu, projektuesi konstruktor do të hartojë</i>

		projektin konstruktiv të zbatimit, duke përfshirë detajimin e elementeve strukturorë, ndërhyrjet për rritjen e sigurisë dhe qëndrueshmërisë së objektit, në përputhje me standardet dhe normat teknike në fuqi, si dhe në funksion të kërkesave të projektit për rikonstruksion dhe riorganizim të hapësirave.
Kat. 4. PROJEKTUES INSTALATOR	a-Projektim të instalimeve hidro-termosanitare; b-Projektim të instalimeve termoteknike- kondicionimi, si dhe të impianteve të prodhimit të energjisë termike nga burime të rinovueshme; c-Projektim të linjave të rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale; f- Projektim të sistemeve kundra zjarrit.; h- Projektimi i impianteve ngritëse të transportues (ashensore, shkallë levizëse, etj.; j- Projektim të rrjeteve të telefonisë, citofonisë, fonisë, internetit, TV, akses kontroll, CCTV, sistemet e alarmit, sistemet e dedektimit të zjarrit, etj., për objektet civile dhe industriale;	Bazuar në Termat e Referencës, kjo kategori është e domosdoshme për analizën dhe projektimin e të gjitha sistemeve inxhinierike të godinës, në funksion të rikonstruksionit dhe përshtatjes së hapësirave mësimore. Ai do të hartojë projektet për instalimet hidrosanitare dhe rrjetet e kanalizimeve, instalimet elektrike dhe sistemet e furnizimit me energji, sistemet HVAC (ngrohje, ventilitim dhe kondicionim), si dhe zgjidhjet për eficiencën energjetike të objektit. Gjithashtu, do të projektojë sistemet e mbrojtjes nga zjarri (MNZ), përfshirë detektimin, alarmimin dhe rrjetet përkatëse, sistemet e telekomunikacionit dhe rrjetet e internetit, si dhe impiantet ngritëse (ashensorin) të parashikuara në ndërhyrje. Projektuesi do të sigurojë integritetin dhe koordinimin e të gjitha instalimeve me projektin arkitektonik dhe konstruktiv, duke garantuar përputhjen me standardet teknike dhe kërkesat funksionale të objektit arsimor.
5. PROJEKTUES VEPRË HIDRAULIKE	b- Furnizim me ujë - kolektorë shkarkimi.	Bazuar në Termat e Referencës, projektuesi i veprave hidraulike është i domosdoshëm për analizën dhe projektimin e rrjeteve të jashtme dhe të brendshme të furnizimit me ujë dhe shkarkimit të ujërave të ndotura dhe atmosferike, në funksion të rikonstruksionit të objektit dhe përmirësimit të kushteve ekzistuese. Ai do të hartojë zgjidhjet teknike për sistemet e kanalizimeve, drenazhimin dhe menaxhimin e ujërave të shiut, si dhe lidhjen e tyre me rrjetet

		<i>ekzistuese publike. Gjithashtu, projektuesi do të sigurojë koordinimin e këtyre sistemeve me projektet e tjera inxhinierike dhe kërkesat funksionale të objektit, duke garantuar përputhjen me standardet teknike dhe kërkesat e projektit për rikonstruksion.</i>
8. PROJEKTUES GJEODET	a- Rivetime inxhinierike.	<i>Bazuar në Termat e Referencës, projektuesi gjeodet është i domosdoshëm për kryerjen e rilevimit topografik të zonës së ndërhyrjes, përfshirë përcaktimin e kufijve të parcelës, elementeve ekzistuese dhe rrjeteve inxhinierike. Ai do të realizojë krijimin e pikave të kontrollit gjeodezik, matjet planimetrike, përpunimin e të dhënave dhe hartimin e planeve të rilevimit, seksioneve dhe dokumentacionit përkatës. Gjithashtu, projektuesi gjeodet do të hartojë planet e pozicionimit dhe piketimit, duke siguruar saktësinë e vendosjes së objektit në terren dhe mbështetjen teknike për fazat e projektimit dhe zbatimit, në përputhje me kërkesat e projektit dhe standardet teknike në fuqi.</i>

2.3.3 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik për ekzekutimin e objektit të prokurimit, të përfshirë në licensën e shoqërisë, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, CV, diplomë dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për muajin e fundit të deklaruar nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, konkretisht:

- 1 (nje) Arkitekt
- 1 (nje) Inxhinier Ndërtimi
- 1 (nje) Inxhinier Hidroteknik
- 1 (nje) Inxhinier Elektrik
- 1 (nje) Inxhinier Mekanik
- 1 (nje) Inxhinier Gjeodet/Topograf/Markshajder

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: Spas Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar Neni 77 Kërkesat për kualifikim, pika 4 Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Stafi i mesiperm, do të realizojë projektet sipas kompetencës dhe licences bazuar në VKM nr.759, datë 12.11.2014 “Për licencimin profesional të individëve dhe personave

juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. Drejtuesit teknik si më sipër duhet të jenë të punësuar prane shoqërisë dhe të përmbushin kriteret sipas parashikimeve të vendimit nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016”.

2.3.4. Operatorët ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë staf (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë, mund ta disponojë edhe me kontrate pune/kontrate bashkëpunimi) të vertetuar me kontrate pune të vlefshme, CV, diplome dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për muajin e fundit të deklaruar nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, konkretisht:

- 1 (një) Inxhinier Elektronik/IT/Telekomunikacion

Ne rast se stafi i mesipër do të jetë i OE pjesëmarrës, duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për muajin e fundit.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

2.3.5 Operatorët ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë si staf mbështetës me kontratë individuale të punës (të vlefshme)/kontratë bashkëpunimi, Çertifikatë, si më poshtë:

- 1 (një) Auditues Energjitik i Certifikuar nga Agjensia për Eficencën e Energjisë për të kryer auditime në Ndërtesa;
- 1 (një) punonjës të pajisur me certifikate lëshuar nga Ministria e Mjedisit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis;
- 1 (një) Ekspert Zjarrefikës në fushën e mbrojtjes nga Zjarri dhe për shpëtim” në përputhje me Ligjin Nr. 152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin”, shoqëruar me Diplomë/Certifikatë dhënë nga Drejtoria MZSH.

Shënim: Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë një liste personeli kryesor të nevojshme për të zbatuar objektin e prokurimit dhe /ose komponentet e saj, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Njesia e prokurimit për vendosjen e stafit ndihmës i është referuar Termave References .

Eshtë parashikuar edhe mundësia që stafi i mesiperm sipas pikën 2.3.4 dhe 2.3.5 të mund të sigurohet edhe nepermjet kontrates së punës apo kontrates së bashkepunimit enkas për këto kontrate. Kjo rrit konkurrencën dhe siguron gare të barabarte. Vetëm në rast se stafi i mesiperm do të jete i Operatorit Ekonomik pjesëmarrës, duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për muajin e fundit. Në rast se stafi i mesiperm sigurohet nepermjet kontrates së punës apo kontrates së bashkepunimit, nuk është kusht përfshirja në list pagese për muajin e fundit.

2.3.6 Një punësim minimalisht prej **10 (dhjetë)** punonjës, të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për muajin e fundit të deklaruar nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës vërtetuar me:

- a. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore minimumi për muajin e fundit të deklaruar nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.
- b. Listpagesat e punonjesve të konfirmuara nga autoritetet perkatese sipas formatit që kërkohej nga legjislacioni në fuqi minimumi për muajin e fundit të deklaruar shpalljes së njoftimit të kontratës.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: Kërkesa për stafin bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenin 41, pika 4, gërma ”c” të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar ku parashikohet se: 4. *Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.* Për përcaktimin e fuqisë punëtore minimale të kërkuar argumentojmë se jemi bazuar në shërbimet e kërkuara sipas Termave të Referencës. Numri i përcaktuar është si rezultat i analizës së volumit të shërbimit, afatit të kontratës dhe organizimit minimal të nevojshëm për realizimin e saj. Ky kriter është në proporcion me objektin, vlerën dhe kompleksitetin e kontratës. Kërkimi i listëpagesës së muajit të fundit dhe vërtetimit nga Administrata Tatimore synon të provojë se operatori ekonomik disponon ka kapacitetet e nevojshme për realizimin e kontrates.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat si më poshtë:

- a) Certifikatën e cilësisë së punimeve SSH/DIN/EN/UNI/ **ISO 9001-2015 e perditesuar** (e vlefshme)/ose/ekuivalent. Certifikata të jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- b) Certifikatën për Sistemin e menaxhimit të mjedisit SSH/DIN/EN/UNI/ **ISO 14001-2015 e perditesuar, ISO 14001-2026** (e vlefshme), ose/ ekuivalent. Certifikata të jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- c) Certifikatën SSH/DIN/EN/UNI/ **ISO 50001-2018, e përditësuar**, e vlefshme/ ose ekuivalent (Sistemi i Menaxhimit të Energjisë e vlefshme ose ekuivalent). Certifikata të jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, Operatori ekonomik do të paraqesë ISO-t në baze të zerave të shërbimeve që ka marrë persiper të realizojë.

Pranohet dhe paraqitja e standardeve shqiptare **SSH/DIN/EN/UNI** mbi konformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

Çertifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Argumentim: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 2.3.7 gërma “a - c” është vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 79, pika 1 ku përcaktohet se: *1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, si dhe në nenin 44, pika 1 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.*

SSH/DIN/EN/UNI ISO 9001:2015 e vlefshme / ekuivalente është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërmarrjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërmarrje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërmarrjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Kjo ISO konsiderohet e lidhur drejtpërdrejt me objektin e kontratës dhe proporcionale me natyrën e shërbimit që do të realizohet.

SSH/DIN/EN/UNI/ISO 14001:2015 , ISO 14001-2026 ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me **ISO 14001:2015, ISO 14001-2026** me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana e tij (në rastin konkret

realizimi i objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

SSH/DIN/EN/UNI ISO 50001-2018 është standart ndërkombëtar, i cili specifikon kërkesat e përgjithshme për krijimin e një Sistemi të Menaxhimit të Energjisë në një organizatë dhe fokusohet në identifikimin e mundësive për përmirësimin e performancës së energjisë. ISO 50001 përcakton synimet dhe objektivat specifike për kursimin e energjisë, të cilat arrihen përmes programeve për menaxhimin e energjisë dhe monitorimin sistematik të variablave të energjisë.

2.3.8 Operatori/et Ekonomik duhet të ketë në pronësi ose me qera:

- 1 (një) Pajisje GPS
- 1 (një) Total Station

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri, duhet të paraqitet dokumentacioni i vlefshëm, si më poshtë: dokumentacion për pajisjen në pronësi, ose me qera, ose me huapërdorje (fatura blerje / dokumente zhdoganimit / kontrata qiraje / çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë).

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: Kërkesa e mesiperme është vendosur sipas pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe në nenin 41, pika 4 gërma (ç) ku parashikohet se: “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.” Për përcaktimin e pajisjeve dhe makinerive të kërkuara, argumentohet se është bazuar në shërbimet e parashikuara sipas Termave të Referencës. Vendosja e këtij kriteri është bërë në përputhje me nevojën për realizimin e suksesshëm të shërbimit për objektin.

Shënim: Kandidati ofertues në përlllogaritjen e ofertës duhet ti referohet njoftimit të bërë me Nr. 5585 Prot. datë 25.07.2017 të Agjensisë së Prokurimit Publik “Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar nga një shtet të huaj. Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e

origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike, termat e referencës dhe përlllogaritja e fondit limit janë përgatitur dhe hartuar nga Autoriteti Kontraktor “Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive”, për nevojat e së cilit, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara, në cilësinë e Organit Qendror Blerës kryen procedurën e prokurimit, në zbatim të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM-në nr.531 datë 7.9.2023 “Për krijimin e shoqërisë aksionare shtetërore “Operatori i Blerjeve të Përqëndruara” Sh.a për kryerjen e procedurave të veçanta të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, Ministrive dhe Institucioneve të Varësise”, i ndryshuar.

Specifikimet teknike janë hartuar në përputhje me nenin 36 të LPP 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar si dhe nenin 41 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Neni 36 pika 3 përcakton: 3. *Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar: a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;*

Duke ju referuar nenit 36 autoriteti kontraktor përfitues Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, ka hartuar specifikimet teknike të cilat shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor përfitues.

Çdo standard i kërkuar apo çdo referencë marke të shërbimeve objekt prokurimi, autoriteti kontraktor do të pranojë edhe ekuivalentin e tij.

Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurim.